



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr. 106**

**22 gusht**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

|   |  | Faqe |
|---|--|------|
| Ligj nr. 76/2012<br>datë 26.7.2012          | Për ratifikimin e marrëveshjes për statusin ligjor të Qendrës Rajonale të Mjedisit për Europën Qendrore dhe Lindore..... | 5919 |
| Ligj nr. 77/2012<br>datë 26.7.2012          | Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare.....  | 5920 |
| Ligj nr. 78/2012<br>datë 26.7.2012          | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.....         | 5925 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 36, datë 26.7.2012 | Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Artan Zeneli Anëtar i Gjykatës së Lartë.....                                 | 5930 |
| Rezolutë e Kuvendit<br>datë 19.7.2012       | Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011.....                                    | 5931 |
| Rezolutë e Kuvendit<br>datë 19.7.2012       | Për raportin e Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2011”.....                            | 5932 |
| Dekret nr. 7729<br>datë 6.8.2012            | Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....  | 5933 |
| Dekret nr. 7730<br>datë 6.8.2012            | Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....  | 5934 |
| Dekret nr. 7731<br>datë 6.8.2012            | Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....  | 5934 |
| Dekret nr. 7732<br>datë 7.8.2012            | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....  | 5935 |

Vendim i GjL  
nr. 2, datë 27.3.2012

Me objekt: 1. Detyrimi i të paditurit Aleksandër Miraj me cilësinë e palës investitore, të realizojë në mënyrë të plotë në natyrë, në favor të paditësve dhe ndërhyrësve kryesorë, detyrimet që rrjedhin nga kontrata e investimit lidhur midis palëve në datë 13.10.2002, si dhe kontratat e shkëmbimit datë 24.5.2004 dhe 25.5.2004 të llogaritura me koeficientin 20% të sipërfaqes ndërtimore të objektit 8 katësh. Në pamundësi të realizimit 100% në natyrë të këtij detyrimi, sipas kuotave, detyrimin e tij ta kompensojë në vlerë me çmimin e tregut aktual për secilin bashkëpronar.

2. Detyrimin e ZVRPP Durrës të realizojë korrigjimet, regjistrime, në bazë të raporteve që krijohen nga ky gjykim.

3. Pushimin e gjykimit për pjesën e objektit të padisë që i përket Fiqiri Ushina.....

**LIGJ**  
**Nr. 76/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR STATUSIN LIGJOR TË QENDRËS RAJONALE  
TË MJEDISIT PËR EUROPËN QENDRORE DHE LINDORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja për statusin ligjor të Qendrës Rajonale të Mjedisit për Europën Qendrore dhe Lindore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.7.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7739, datë 16.8.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**

**MBI STATUSIN LIGJOR TË QENDRËS RAJONALE TË MJEDISIT PËR EUROPËN QENDRORE  
DHE LINDORE**

Palët e kësaj Marrëveshjeje,

*duke marrë në konsideratë* se Qendra Rajonale e Mjedisit për Europën Qendrore dhe Lindore (REC) u krijua në vitin 1990 dhe iu dha misioni për të ndihmuar në trajtimin e çështjeve mjedisore kryesisht në Europën Qendrore dhe Lindore;

*duke iu referuar* Kartës së REC-it të vitit 1996 (më poshtë e quajtur “Karta”);

*duke pranuar* se REC-i është zhvilluar gjatë kohës duke u kthyer *de facto* në një organizatë ndërkombëtare që ndjek një mandat ndërkombëtar, e përbërë nga zyra kryesore dhe një rrjet të zyrave nëpër vende;

*duke iu referuar* “Deklaratës së nënshkruesve të Kartës së Qendrës Rajonale të Mjedisit për Europën Qendrore dhe Lindore me rastin e 20 vjetorit të themelimit të REC-it, miraturar më 18 qershor 2010, në të cilën nënshkruesit rekomanduan “Të lehtësohet harmonizimi me anë të përfundimit të një instrumenti të ri, opsional, shumëpalësh për nënshkruesit e interesuar”;

*të bindur* se është e nevojshme të krijohet mundësia për nënshkruesit e Kartës që të bëhen palë e një marrëveshjeje në të cilën personaliteti ligjor ndërkombëtar i jepet shprehimisht REC-it, pa ndryshuar funksionin aktual të Kartës si dokumenti bazë për funksionimin e REC-it,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Palët e kësaj Marrëveshjeje pranojnë se REC-i është një organizatë ndërkombëtare me seli në Szentendre, Hungari.

2. Palët e kësaj Marrëveshjeje pranojnë se REC-i ka personalitet ligjor ndërkombëtar. Ajo ka



gjithashtu kapacitet të tillë ligjor siç mund të jetë e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj dhe përmbushjen e qëllimeve të saj, duke përfshirë aftësinë për të kontraktuar, për të blerë dhe për të disponuar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe për të filluar dhe marrë pjesë në procedime ligjore.

#### Neni 2

Kjo Marrëveshje nuk ndikon në objektivat, karakteristikat dhe strukturën institucionale të REC-it, siç deklarohet në Kartë dhe nuk ndikon gjithashtu në statusin ligjor të REC-it për nënshkruesit e Kartës që nuk janë palë të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 3

Kjo Marrëveshje nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet e REC-it, të cilat mund të rrjedhin nga marrëveshjet ose rregullimet kontraktuale që ajo mund të ketë nënshkruar me ndonjë qeveri apo palë të tretë.

#### Neni 4

Asnjë palë e kësaj Marrëveshjeje, për shkak të dispozitave të saj, nuk është përgjegjëse për veprimet, mosveprimet, detyrimet apo borxhet e REC-it.

#### Neni 5

1. Kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim nga nënshkruesit e Kartës.
2. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit, miratimit ose pranimit. Instrumentet e ratifikimit, miratimit ose pranimit depozitohen pranë Qeverisë së Republikës së Hungarisë.
3. Kjo Marrëveshje mbetet e hapur për aderim nga çdo nënshkrues i Kartës. Instrumentet e aderimit depozitohen pranë Qeverisë së Republikës së Hungarisë.
4. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë pas ditës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, miratimit ose pranimit. Për çdo nënshkrues të Kartës që ratifikon, miraton, pranon ose aderon në këtë Marrëveshje pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, miratimit ose pranimit, Marrëveshja do të hyjë në fuqi 30 ditë pas ditës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, miratimit, pranimit ose aderimit nga ky nënshkrues i Kartës.

Bërë në..... më.....

### **LIGJ Nr. 77/2012**

#### **PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KONFERENCËS GJYQËSORE KOMBËTARE**

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 shkronja “a” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

#### Neni 1

#### **Konferenca Gjyqësore Kombëtare**

1. Konferenca Gjyqësore Kombëtare (KGJK) është mbledhja e të gjithë gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë, gjyqtarëve të gjykatave të apelit dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.
2. KGJK-ja është person juridik publik.

## Neni 2

### **Burimet e financimit**

1. KGJK-ja ka buxhet të veçantë që administrohet nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në bashkëpunim me Këshillin Ekzekutiv të Konferencës.

2. Burimet e financimit të KGJK-së janë Buxheti i Shtetit dhe të ardhura të tjera, të lejuara nga ligji. KGJK-ja përcakton në rregulloren e saj masën dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të tjera.

3. Buxheti për KGJK-në parashikohet, si zë më vete, në buxhetin vjetor të gjykatave.

## Neni 3

### **Kompetencat e Konferencës Gjyqësore Kombëtare**

KGJK-ja ka këto kompetenca:

a) zgjedh anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje me nenin 147 pika 1 të Kushtetutës;

b) miraton rregulloren e KGJK-së;

c) mbron dhe promovon pavarësinë e pushtetit gjyqësor;

ç) diskuton për drejtimit kryesore të veprimtarisë së gjykatave;

d) paraqet deklarata dhe rekomandime tek autoritetet përkatëse shtetërore për një administrim të paanshëm dhe efikas të gjykatave të Shqipërisë;

dh) paraqet rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional të pushtetit gjyqësor;

e) zgjedh komisionet e përhershme dhe të posaçme, sipas këtij ligji;

ë) ushtron çdo kompetencë tjetër të përcaktuar me ligj.

## Neni 4

### **Organet drejtuese të Konferencës Gjyqësore Kombëtare**

Organet drejtuese të KGJK-së janë:

a) Mbledhja e Përgjithshme e KGJK-së;

b) Këshilli Ekzekutiv i KGJK-së;

c) Kryetari i KGJK-së;

ç) Zëvendëskryetari i KGJK-së.

## Neni 5

### **Mbledhja e përgjithshme e KGJK-së**

1. Mbledhja e përgjithshme e KGJK-së është mbledhja e të gjithë gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë, gjyqtarëve të gjykatave të apelit dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe është organi më i lartë vendimmarrës i KGJK-së.

2. Në të marrin pjesë gjithashtu edhe gjyqtarët që shërbejnë në strukturat e tjera shtetërore, sipas nenit 28 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për aq kohë sa ruajnë statusin e gjyqtarit, por pa të drejtë për t’u zgjedhur anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

## Neni 6

### **Këshilli Ekzekutiv i KGJK-së**

1. Këshilli Ekzekutiv i KGJK-së mbikëqyr organizimin dhe administrimin e brendshëm të KGJK-së. Ai përbëhet nga:

a) Kryetari i Gjykatës së Lartë;

b) 8 gjyqtarë të gjykatave të shkallës së parë;

c) 5 gjyqtarë të gjykatave të apelit;

ç) 1 gjyqtar i Gjykatës së Lartë.



2. Anëtarët e Këshillit Ekzekutiv zgjidhen nga KGJK-ja dhe qëndrojnë në detyrë për 3 vjet. Ata zgjidhen në mbledhjen e përgjithshme të KGJK-së, me votim të fshehtë dhe me shumicën e votave të të pranishmëve. Rregulla më të hollësishme për zgjedhjen e tyre përcaktohen në rregulloren e KGJK-së.

3. Këshilli Ekzekutiv kryesohet nga Kryetari i KGJK-së.

4. Këshilli Ekzekutiv mblidhet me kërkesë me shkrim të Kryetarit të KGJK-së, të një të tretës së anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv ose të një të pestës së anëtarëve të KGJK-së.

5. Kërkesa me shkrim për thirrjen e Këshillit Ekzekutiv përmban edhe çështjet për të cilat kërkohet mbledhja e tij. Njoftimi i mbledhjes dhe rendi i ditës u njoftohen anëtarëve të Këshillit të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për zhvillimin e mbledhjes.

6. Këshilli Ekzekutiv:

a) cakton rendin e ditës për mbledhjet e përgjithshme të KGJK-së;

b) raporton përpara çdo mbledhjeje për veprimtarinë e tij që nga mbledhja e fundit e KGJK-së;

c) miraton projektbuxhetin e KGJK-së, të propozuar nga komisioni i buxhetit të KGJK-së;

ç) harton projektregulloren e KGJK-së, si dhe çdo projekt për ndryshimin apo shtimin e saj;

d) ushtron çdo kompetencë tjetër të parashikuar me ligj apo të ngarkuar nga mbledhja e përgjithshme e KGJK-së.

7. Mbledhja e Këshillit Ekzekutiv është e vlefshme kur në të marrin pjesë të paktën 8 anëtarë të tij. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

#### Neni 7

### **Kryetari i KGJK-së dhe zëvendësi i tij**

1. Kryetari i KGJK-së është Kryetari i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

2. Kryetari i KGJK-së organizon dhe drejton punën e Konferencës, si dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

3. Kryetari i KGJK-së drejton mbledhjen e përgjithshme të KGJK-së, si dhe mbledhjet e Këshillit Ekzekutiv.

4. Në rast mungese të kryetarit, detyrat e tij kryhen nga Zëvendëskryetari i KGJK-së. Zëvendëskryetari zgjidhet prej Këshillit Ekzekutiv nga radhët e tij, me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës të të gjithë anëtarëve të tij.

#### Neni 8

### **Funksionimi i KGJK-së**

1. KGJK-ja mblidhet të paktën një herë në vit në mbledhje të përgjithshme.

2. Mbledhjet e përgjithshme të KGJK-së thirren me kërkesë me shkrim të Kryetarit të KGJK-së, të një të tretës së anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv ose të një të pestës së anëtarëve të KGJK-së. Kërkesa me shkrim për thirrjen e KGJK-së përmban edhe çështjet për të cilat kërkohet mbledhja.

3. Për mbledhjen e përgjithshme të KGJK-së njoftohen me shkrim të gjithë anëtarët e saj, të paktën 30 ditë përpara datës së caktuar për zhvillimin e saj. Kur mbledhja e përgjithshme e KGJK-së thirret për zgjedhjen e anëtarëve të KLD-së ose me kërkesë me shkrim të anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv ose të anëtarëve të KGJK-së, afati i njoftimit mund të shkurtohet, por në çdo rast anëtarët duhet të njoftohen të paktën 10 ditë përpara datës së mbledhjes.

4. Shërbimet e nevojshme administrative dhe teknike për funksionimin e KGJK-së kryhen nga stafi i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

#### Neni 9

### **Zgjedhja e anëtarëve për Këshillin e Lartë të Drejtësisë**

1. KGJK-ja zgjedh anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në mbledhjen e përgjithshme të saj në përputhje me nenin 147 të Kushtetutës dhe me legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Anëtarët e KLD-së, që zgjidhen nga KGJK-ja, duhet të jenë:
  - a) 5 gjyqtarë të gjykatave të shkallës së parë;
  - b) 3 gjyqtarë të gjykatave të apelit;
  - c) 1 gjyqtar i Gjykatës së Lartë.
3. Procedura për zgjedhjen e anëtarëve të KLD-së fillon me urdhër të veçantë të Kryetarit të KGJK-së për thirrjen e KGJK-së:
  - a) të paktën 90 ditë para datës kur mbaron mandati i anëtarit përkatës;
  - b) brenda 45 ditëve nga mbarimi para afatit të mandatit të anëtarit përkatës, ose kur KLD-ja ka çmuar se zgjedhja e anëtarit të KLD-së nuk ka qenë në përputhje me ligjin.
4. Kandidatët për anëtarë të KLD-së duhet të propozohen me shkrim nga të paktën 10 gjyqtarë, që nënshkruajnë propozimin. Këtij propozimi i bashkëngjitet edhe pëlqimi me shkrim i gjyqtarit që kandidon, së bashku me jetëshkrimin përkatës. Një gjyqtar mund të mbështesë vetëm një kandidaturë për çdo vend vakant në KLD.
5. Gjyqtarët, ndaj të cilëve janë marrë masa disiplinore, për aq kohë sa këto masa janë në fuqi, ndalohen të kandidojnë për anëtarë të KLD-së.
6. Kandidaturat paraqiten deri në 7 ditë para datës së caktuar për votimin e tyre nga KGJK-ja në mbledhjen e përgjithshme të saj.

#### Neni 10

### **Procedura e votimit të anëtarëve të KLD-së**

1. Komisioni i etikës, verifikimit të mandateve dhe i përmirësimit të vazhdueshëm profesional shqyrton plotësimin e kriterëve formalo-ligjore të kandidatëve dhe paraqet para KGJK-së raport me shkrim nëse kandidatët i plotësojnë këto kriterë. Për këtë qëllim, komisioni i kërkon informacion me shkrim Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili duhet të përgjigjet brenda 48 orëve nga marrja e kërkesës.
2. Anëtarët e KLD-së zgjidhen me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KGJK-së. Në rast se në votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk ka marrë votat e kërkuara, menjëherë zhvillohet një votim i dytë mes 2 kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave për vendin vakant. Në rast se edhe në votimin e dytë asnjë kandidat nuk merr shumicën e kërkuar të votave, procesi i zgjedhjes së anëtarëve të KLD-së rifillon me paraqitjen e kandidaturave të reja. Mbledhja e KGJK-së thirret brenda 3 ditëve dhe votimi zhvillohet jo më vonë se 25 ditë.
3. Procedura më e hollësishme e thirrjes së mbledhjes së KGJK-së dhe e kryerjes së votimit, ngritja e komisionit të votimit, mënyra e numërimit dhe nxjerrja e rezultatit të votimit përcaktohen në rregulloren e KGJK-së.

#### Neni 11

### **Marrëdhëniet e të zgjedhurve në KLD me KGJK-në**

1. Në mbledhjen e përgjithshme vjetore të KGJK-së anëtarët e zgjedhur në KLD prej KGJK-së, në mënyrë individuale ose kolegjialisht, duhet të paraqesin një raport të hollësishëm për ushtrimin e përgjegjësisë të pushtetit gjyqësor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.
2. Në përfundim të raportimit, KGJK-ja mund të miratojë një rezolutë, nëpërmjet së cilës përcakton drejtimit kryesor të veprimtarisë së përfaqësuesve të saj në KLD për vitin e ardhshëm, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.
3. Anëtarët e KLD-së, të zgjedhur nga KGJK-ja, nuk mund të paraqesin kërkesë për transferim apo ngritje në detyrë gjatë ushtrimit të mandatit të tyre.

#### Neni 12

### **Komisionet e KGJK-së**

1. Komisionet e KGJK-së këshillojnë dhe i paraqesin rekomandime KGJK-së, Këshillit Ekzekutiv apo organeve të tjera shtetërore, në lidhje me politikat dhe programet, sipas fushave të tyre të kompetencës. Komisionet dorëzojnë një raport me shkrim me rekomandime, sipas rastit, në çdo mbledhje të KGJK-së.



2. Anëtarët e komisioneve të KGJK-së propozohen nga Kryetari i KGJK-së ose nga një e pesta e anëtarëve të KGJK-së dhe zgjidhen nga KGJK-ja me votim të hapur. Kryetari i komisionit zgjidhet nga vetë anëtarët e komisionit. Në komision bëjnë pjesë gjyqtarë me njohuri dhe përvojë në fushën që mbulon veprimtaria e komisionit.

3. KGJK-ja krijon këto komisione të përhershme:

a) Komisionin e buxhetit, i cili këshillon dhe i paraqet rekomandime edhe Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për përcaktimin e nevojave të gjykatave. Anëtarët e bordit drejtues të kësaj zyre janë anëtarë, për shkak të detyrës, të komisionit të buxhetit;

b) Komisionin e etikës, verifikimit të mandateve dhe të përmirësimit të vazhdueshëm profesional, i cili i paraqet rekomandime edhe:

i) Shkollës së Magjistraturës për programe të reja, si dhe për ndryshime në programet ekzistuese për përmirësimin e vazhdueshëm profesional të gjyqtarëve dhe të punonjësve të tjerë të gjykatave. Gjyqtarët që janë anëtarë të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës janë anëtarë për shkak të detyrës të këtij komisioni;

ii) Inspektoratit të KLD-së dhe të Ministrisë së Drejtësisë, nëse një veprim apo veprimtari bie ndesh me rregullat e kodit të etikës;

c) Komisionin për marrëdhëniet me institucionet shtetërore, organizatat ndërkombëtare, mediat, organizatat jofitimprurëse dhe publikun, i cili i paraqet rekomandime edhe:

i) Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë për hartimin e legjislacionit që lidhet me veprimtarinë e gjykatave;

ii) institucioneve të tjera shtetërore, me qëllim promovimin e arritjeve të pushtetit gjyqësor si shërbim publik dhe për ndikimin në rritjen e besimit të publikut te drejtësia. Komisioni siguron që veprimtaria e gjykatave të pasqyrohet në mënyrën e duhur në media, në këto organizata dhe në publik, si dhe mban lidhje me to.

4. KGJK-ja, sipas nevojave, mund të krijojë edhe komisione të tjera, të përhershme ose të posaçme.

#### Neni 13

#### **Dispozitë kalimtare**

1. Kryetari i KGJK-së, me hyrjen në fuqi të këtij ligji:

a) emëron Këshillin Ekzekutiv të Përkohshëm me 7 anëtarë, i cili harton projektregulloren për t'u prezantuar në mbledhjen e parë të KGJK-së, në zbatim të këtij ligji;

b) cakton datën e thirrjes së mbledhjes së parë të KGJK-së, në zbatim të këtij ligji, duke respektuar procedurën e parashikuar në nenin 8 të këtij ligji;

c) emëron komisionin e përkohshëm me 5 anëtarë për verifikimin e kriterëve formalo-ligjore të kandidatëve për t'u zgjedhur anëtarë të KLD-së, nëse ekziston ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në pikën 3 të nenit 9 të këtij ligji.

2. KGJK-ja merr masat që në mbledhjet e radhës për zgjedhjen e anëtarëve të KLD-së të zbatojë, për aq sa është e mundur, pikën 2 të nenit 9 të këtij ligji, deri në arritjen e raportit të përcaktuar në këtë nen.

3. Në mbledhjen e parë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në rendin e ditës së mbledhjes është miratimi i rregullores së KGJK-së dhe zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv, sipas rregullave të nenit 6 të këtij ligji.

#### Neni 14

#### **Miratimi i rregullores së KGJK-së**

Në mbledhjen e përgjithshme të KGJK-së, në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, miratohet rregullorja e saj bazuar në parimet e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, të barazisë gjinore dhe të përfaqësimit të drejtë.



Neni 15  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.7.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7740, datë 16.8.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**LIGJ**  
**Nr. 78/2012**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8873, DATË 29.3.2002 “PËR  
SIGURIMIN E DEPOZITAVE”, TË NDRYSHUAR<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1” me këtë përmbajtje:  
“ç/1) “Shoqëria e kursim-kreditit (SHKK)” është personi juridik, i cili themelohet dhe vepron në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8782, datë 3.5.2001 “Për shoqëritë e kursim-kreditit”, të ndryshuar;”.
2. Pas shkronjës “d” shtohet shkronja “d/1” me këtë përmbajtje:  
“d/1) “Subjekt i siguar” është banka dhe dega e bankës së huaj në Shqipëri, shoqëria e kursim-kreditit që pranon depozita të siguruara nga Agjencia;”.
3. Në shkronjën “f”, pas nënndarjes “ii” shtohet nënndarja “iii” me këtë përmbajtje:  
“iii) çdo shumë parash, që anëtar, individ i shoqërisë së kursim-kreditit depoziton pranë saj, në përputhje me ligjin nr. 8782, datë 3.5.2001 “Për shoqëritë e kursim-kreditit”, të ndryshuar;”
4. Shkronja “ll” ndryshohet si më poshtë:  
“ll) “Ndërhyrje” është vënia në likuidim të detyruar e subjektit të siguar me vendim të Autoritetit Mbikëqyrës;”.

---

<sup>1</sup> Ky ligj është përafëruar pjesërisht me:  
Direktivën 1994/19/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 30 maj 1994 “Mbi skemat e garantimit të depozitave”, Numri CELEX: 31994L0019, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 135, datë 31.5.1994, faqe 5 – 14, e ndryshuar nga Direktiva 2005/1/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 9 mars 2005, “që amendon Direktivat 73/239/KEE, 85/611/KEE, 91/675/KEE, 92/49/KEE, 93/6/KEE dhe direktivat 94/19/KE, 98/78/KE, 2000/12/KE, 2001/34/KE, 2002/83/KE dhe 2002/87/KE, me qëllim për të krijuar një strukturë të re organizative për Komisionet e Shërbimeve Financiare”, Numri CELEX: 32005L0001, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L nr. 79, datë 24.3.2005, faqe 9 – 17 dhe nga Direktiva 2009/14/KE, e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 11 mars 2009, “që ndryshon Direktivën 94/19/KE “Mbi skemat e garantimit të depozitave lidhur me nivelin e mbulimit dhe vonesën e pagimit”, Numri CELEX: 32009L0014, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 68, datë 13.3.2009, faqe 3–7.



## Neni 2

Pas nenit 2 shtohet neni 2/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 2/1

Kudo në këtë ligj fjalët “bankë e siguruar” zëvendësohen me fjalët “subjekt i siguruar”, me përjashtim të neneve 23 dhe 26 të këtij ligji.”.

## Neni 3

Në nenin 3, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Depozita në shoqëritë e kursim-kreditit sigurohet nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve rregullatore, dhe asnjë shoqëri e kursim-kreditit nuk pranon dhe nuk grumbullon depozita kur nuk është e siguruar nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji.”.

## Neni 4

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) depozitat e drejtorit, të administratorëve të subjektit të siguruar ose të çdo depozituesi tjetër me të njëjtin status në personat juridikë të lidhur me subjektin e siguruar në fjalë.”.

2. Pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje:

“gj) depozitat e personave juridikë në shoqërinë e kursim-kreditit.”.

## Neni 5

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Agjencia kompenson depozitat e siguruar kur Autoriteti Mbikëqyrës ndërhyt në subjektin e siguruar.”.

2. Shkronja “c” e pikës 4 ndryshohet si më poshtë:

“c) depozitat e siguruar, të mbajtura nga çdo depozitues në subjektin e siguruar në ditën e ndërhyrjes, agregohen. Në mbështetje dhe për zbatimin e këtij ligji, agregim është llogaritja e shumës së përgjithshme të depozitave të siguruar të një depozituesi në subjektin e siguruar, duke zbritur vetëm shumën e detyrimeve të papaguara në kohë të depozituesit ndaj subjektit të siguruar, që rezulton në vonesë shlyerjeje në ditën e ndërhyrjes nga Autoriteti Mbikëqyrës.”.

## Neni 6

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, fjalët “ose për vendimin e likuidimit vullnetar” hiqen.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kur shuma e kërkuar për kompensimin e depozitave të siguruar është më e madhe se mjetet financiare të zotëruara nga Agjencia, atëherë kjo e fundit:

a) mund të marrë hua nga Buxheti i Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Masa e huas që do të jepet përcaktohet në mënyrë që kapaciteti financiar i Agjencisë të jetë në proporcion me detyrimet e saj dhe në çdo rast duhet të sigurojë qëndrueshmërinë e sistemit bankar e financiar në vend, si dhe të jetë në përputhje me qëndrueshmërinë e financave publike, në këndvështrimin afatmesëm dhe afatgjatë.

b) Interesi i huas që do të jepet, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, duhet të jetë i njëjtë me normat e interesit të titujve, me maturitet të krahasueshëm, të emtuar nga Qeveria Shqiptare e të tregtueshëm në Republikën e Shqipërisë.

c) Për dhënien e huas, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, Ministria e Financave lidh marrëveshje me Agjencinë dhe Autoritetin Mbikëqyrës, ku përcaktohen, ndër të tjera, kushtet e kësaj huaje.”.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Në rastin e transferimit të disa ose të të gjitha asetëve dhe detyrimeve të subjektit të siguar te një subjekt tjetër i siguar ose një bankë-urë, përfshirë në çdo rast totalin e depozitave të siguruara, në bazë të urdhrin të Autoritetit Mbikëqyrës ose gjatë procesit të kujdestarisë apo likuidimit, Agjencia, me miratimin e Autoritetit Mbikëqyrës, transferon mjetet e saj financiare të nevojshme për plotësimin e diferencës ndërmjet detyrimeve dhe asetëve që transferohen, nëse vlera e detyrimeve është më e madhe se vlera e asetëve.

a) Plotësimi i diferencës, nga ana e Agjencisë, ndërmjet detyrimeve dhe asetëve që transferohen, kryhet deri në shumën e depozitave të siguruara dhe vetëm nëse kjo mënyrë është më pak e kushtueshme se kryerja e procesit të kompensimit të depozitave, duke përfshirë të gjitha shpenzimet që lidhen me këtë proces.

b) Pretendimet e Agjencisë, të cilat rrjedhin nga plotësimi i diferencës midis detyrimeve dhe asetëve të transferuara, renditen në radhë së bashku me depozituesit e vegjël, sipas ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë.”.

#### Neni 7

Në nenin 8, pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“6. Ekzekutimi i detyrimeve të lindura për Agjencinë gjatë procesit të kompensimit pezullohet, sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, deri në përfundimin e plotë të këtij procesi.

7. Vetëm për qëllim të kryerjes së procesit të kompensimit, sipas dispozitave të këtij ligji, Agjencia përjashtohet si subjekt i dispozitave të ligjit “Për prokurimin publik” dhe të akteve nënligjore në fuqi për zbatimin e tij.”.

#### Neni 8

Në nenin 11 pika 2 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës “e” shtohen shkronjat “e/1” dhe “e/2” me këtë përmbajtje:

“e/1) propozon për Autoritetin Mbikëqyrës aktet nënligjore për miratimin e kontributit të veçantë që paguhet nga subjektet e siguruara, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20/1 pika 4 të këtij ligji;

e/2) propozon për miratim të Autoriteti Mbikëqyrës vendimin për transferimin e mjeteve financiare të Agjencisë për plotësimin e diferencës midis asetëve dhe detyrimeve që transferohen nga një subjekt i siguar te një subjekt tjetër i siguar ose bankë-urë, sipas vendimit të Autoritetit Mbikëqyrës për këtë transferim, në përputhje me pikën 6 të nenit 7 të këtij ligji.”.

2. Pas nënndarjes “vi” të shkronjës “ll” shtohet nënndarja “vii” me këtë përmbajtje:

“vii) rregullat dhe procedurat për prokurimin e shërbimeve dhe mallrave gjatë procesit të kompensimit.”.

#### Neni 9

Në nenin 19, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Fondi themeltar i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit është 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë dhe është kontribut i Buxhetit të Shtetit. Ky fond është i pagueshëm sipas kushteve, afateve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

#### Neni 10

Në nenin 20, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1” me këtë përmbajtje:

“ç/1) kontributi i veçantë i subjekteve të siguruara, sipas përcaktimeve në nenin 20/1 pika 4 të këtij ligji.”.



## Neni 11

Në nenin 20/1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Huat apo kreditë e marra nga Agjencia, sipas nenit 20 të këtij ligji, për mbulimin e pamjaftueshmërisë së mjeteve financiare, përfshirë dhe ato që merren nga Buxheti i Shtetit, mund të garantohen me një garanci të lëshuar nga vetë Agjencia, duke përdorur asetet e saj apo pretendimet e ardhshme të Agjencisë për pagimin e primit vjetor nga bankat e siguruara.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Me propozimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë dhe miratimin e Autoritetit Mbikëqyrës, subjektet e siguruara paguajnë një kontribut të veçantë, sipas nenit 20 shkronja “c” të këtij ligji, i cili përmbush kriteret e mëposhtme:

a) Kontributi i veçantë është kontribut i subjekteve të siguruara, që përdoret për qëllim të rindërtimit të mjeteve financiare, në rast të kompensimit të depozitave të siguruara, ose për shlyerjen e huave të Agjencisë të marra për këtë qëllim, në kuptim të nenit 20 shkronja “d” dhe të pikave 4 dhe 5 të këtij neni.

b) Kontributi i veçantë i subjekteve të siguruara mblidhet nga Agjencia vetëm një herë gjatë vitit kalendarik. Masa e kontributit të veçantë përcaktohet e njëjtë për të gjitha subjektet e siguruara dhe në çdo rast jo më shumë se 1 për qind e totalit të depozitave të siguruara që janë regjistruar në subjektin e siguruar në ditën e fundit të muajit pararendës nga data e njoftimit të Agjencisë.

c) Kontributi paguhet nga subjektet e siguruara në lekë me marrjen e njoftimit nga Agjencia për vendimin e Autoritetit Mbikëqyrës mbi detyrimin e pagesës së tij dhe, në çdo rast, jo më vonë se data e përcaktuar në njoftimin e Agjencisë.

ç) Me propozimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë, Autoriteti Mbikëqyrës përcakton subjektet e siguruara, të cilat, për arsye të ruajtjes së aftësisë paguese të tyre, mund të përjashtohen nga pagesa e kontributit të veçantë përkatës.”.

3. Pika 4 bëhet pika 5.

## Neni 12

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21

### **Qëllimi i përdorimit të mjeteve financiare**

Mjetet financiare të Agjencisë, në kuptim të nenit 20 të këtij ligji, përdoren për:

a) kompensimin e depozitave të siguruara, sipas dispozitave të këtij ligji;

b) plotësimin e diferencës ndërmjet detyrimeve dhe aktiveve që transferohen nga një subjekt i siguruar te një subjekt tjetër i siguruar ose bankë-urë, sipas vendimit të Autoritetit Mbikëqyrës për këtë transferim, sipas pikës 6 të nenit 7 të këtij ligji;

c) mbulimin e të gjitha shpenzimeve administrative për zbatimin e procesit të kompensimit të depozitave të siguruara dhe administrimin e asetëve të Agjencisë;

ç) mbulimin e të gjitha shpenzimeve administrative dhe financiare për veprimtarinë e Agjencisë, sipas buxhetit të miratuar nga Autoriteti Mbikëqyrës;

d) shlyerjen e detyrimeve, kredive dhe huave të marra për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni.”.

## Neni 13

Pas nenit 21 shtohet neni 21/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 21/1

**Administrimi i mjeteve financiare**

1. Mjetet likuide të Agjencisë investohen vetëm në:
  - a) tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Autoriteti Mbikëqyrës, në lekë dhe në monedhë të huaj;
  - b) tituj të emetuar nga qeveritë ose bankat qendrore në monedhë të huaj, të cilat konsiderohen të sigurta nga agjenci për vlerësimin e riskut të njohura ndërkombëtarisht;
  - c) tituj të emetuar nga institucionet financiare ndërkombëtare;
  - ç) depozita me interes në Autoritetin Mbikëqyrës.
2. Titujt e blerë nga Agjencia nuk duhet të jenë me maturitet më shumë se një vit që nga momenti i fitimit të pronësisë nga Agjencia.
3. Agjencia administron mjetet e saj financiare me qëllim që:
  - a) të eliminojë shpenzimet e pajustificuara administrative dhe operacionale;
  - b) të administrojë mjete financiare në investime në instrumente financiare me nivel të pranuar rreziku dhe shlyerjeje;
  - c) të garantojë plotësimin, në çdo kohë, të nevojave për mjete financiare likuide të Agjencisë;
  - ç) të zvogëlojë koston e oportunitetit dhe minimizimin e rrezikut të zhvleftësimit të mjeteve financiare të Agjencisë nga luhata në këmbimet valutore;
  - d) të shlyejë në kohë detyrimet.
4. Me synim administrimin e mjeteve të saj financiare, sipas qëllimeve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, Agjencia mund të shesë me detyrim riblerjen e tyre, instrumente të detyrimeve të emetuara nga Ministria e Financave, sipas kushteve të miratuara nga Këshilli Drejtues i Agjencisë dhe Autoriteti Mbikëqyrës.
5. Ministria e Financave, Autoriteti Mbikëqyrës dhe Agjencia hyjnë në marrëveshje ndërmjet tyre për detyrime të parashikuara sipas pikës 4 të këtij neni, lidhur me sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme për kryerjen e procesit të kompensimit nga Agjencia.
6. Agjencia e Sigurimit të Depozitave mban llogari pranë Autoritetit Mbikëqyrës.
7. Agjencia e Sigurimit të Depozitave mban llogari të ndryshme, pranë Autoritetit Mbikëqyrës, mjetet financiare për depozitat e siguruara në bankat dhe degët e bankës së huaj dhe mjetet financiare për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit, në kuptim të nenit 20 të këtij ligji.
8. Pagesat e kontributit fillestar, pagesat e primit vjetor të sigurimit të depozitave, si dhe pagesat e kontributit të veçantë nga subjektet e siguruara derdhen në lekë në llogaritë përkatëse të Agjencisë pranë Autoritetit Mbikëqyrës.”.

Neni 14

Në nenin 24 pika 7, fjalët “bankë e porsalicencuar” zëvendësohen me fjalët “subjekt i porsalicencuar”.

Neni 15

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

**Kontabilizimi i kontributeve dhe i primeve**

1. Kontributet fillestare, primet vjetore dhe kontributet e veçanta llogariten si shpenzime të subjekteve të siguruara.
2. Kontributet fillestare, primet vjetore dhe kontributet e veçanta nuk rimbursohen, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.”.



#### Neni 16

Në nenin 30, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në rastin e transferimit të disa ose të të gjitha aktiveve dhe detyrimeve të bankës te një bankë tjetër ose një bankë-urë, përfshirë në çdo rast totalin e depozitave të siguruara, në rast se ky transferim bëhet në bazë të urdhrit të Autoritetit Mbikëqyrës para, gjatë kujdestarisë ose likuidimit, nuk është e nevojshme të merret miratimi i aksionarëve, depozituesve, kreditorëve ose palëve të treta.”.

#### Neni 17

Në nenin 31 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Shoqëritë e kursim-kreditit, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, marrin të gjitha masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Të gjitha depozitat e anëtarëve individë në shoqëritë e kursim-kreditit do të sigurohen sipas dispozitave të këtij ligji, pas kryerjes të pagesës së kontributit fillestar, sipas njoftimit të Agjencisë.”.

#### Neni 18

Në nenin 32, pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave që, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, t’i propozojë për miratim Autoritetit Mbikëqyrës kuadrin rregullator, në lidhje me përfshirjen e shoqërive të kursim-kreditit në skemën e sigurimit të depozitave, pranimin dhe përfundimin e sigurimit të depozitave, përjashtimin dhe dënimin, sipas dispozitave të parashikuara në këtë ligj.

5. Jo më vonë se 60 ditë kalendrike nga miratimi i kuadrit rregullator, sipas pikës 4 të këtij neni, Agjencia njofton shoqëritë e kursim-kreditit për politikën e sigurimit të depozitave dhe i udhëzon për shumën e kontributit dhe të primit vjetor fillestar që ato do të paguajnë për Agjencinë. Shuma e primit fillestar vjetor është proporcionale me periudhën e mbetur, sipas njoftimit të Agjencisë.”.

#### Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.7.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7741, datë 16.8.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

#### **VENDIM Nr. 36/2012**

#### **PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT ARTAN ZENELI ANËTAR I GJYKATËS SË LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 7250, datë 1.2.2012,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Artan Zeneli anëtar i Gjykatës së Lartë.  
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miraturar në datën 26.7.2012

KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)

**REZOLUTË**  
**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR**  
**VITIN 2011**

**Duke konsideruar se:**

- Zgjedhjet e lira dhe të ndershme përbëjnë themelin e shtetit dhe të demokracisë në çdo vend;
- Nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe të ndershme arrihet legjitimiteti dhe stabiliteti i jetës politike të vendit dhe nxitja e domosdoshme në rrugën e integritit europian;
- Procesi zgjedhor nuk është ekskluzivitet dhe përgjegjësi vetëm e institucioneve zgjedhore, por edhe rezultat i kontributit të përbashkët pozitiv dhe ligjor të të gjithë aktorëve dhe partive politike;

**Kuvendi i Shqipërisë konstaton për vitin 2011 se:**

- Viti 2011 për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ka qenë një vit zgjedhor;
- Veprimtaria e KQZ-së ka qenë transparente dhe publike, në sytë e palëve politike dhe shoqërisë.
- Puna, performanca dhe zhvillimet në KQZ për zgjedhjet vendore të vitit 2011 janë analizuar në raportin e OSBE/ODIHR-it. Ky raport është pranuar nga të gjitha forcat politike në vend.
- Siç rezulton nga raporti i OSBE/ODIHR-it *“klima e përgjithshme politike influençoi punën dhe kolegjalitetin e KQZ-së”*, duke ndikuar negativisht në punën e KQZ-së dhe të administratës zgjedhore në tërësi.

- Mbështetja logjistike dhe financiare e institucionit ka qenë e mjaftueshme për të ushtruar veprimtarinë, në përputhje me ligjin, si dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera, të përfshira në fushën e zgjedhjeve ka qenë në një shkallë optimale.

**Kuvendi kërkon nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2012, në mënyrë të veçantë fokusimin në këto drejtime:**

- Fillimin e menjëhershëm të punës për përgatitjen e zgjedhjeve të vitit 2013, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe standardet ndërkombëtare.

- Të forcojë pavarësinë dhe drejtimin kompetent të institucionit në zbatimin e kornizës ligjore të zgjedhjeve.

- Të forcojë bashkëpunimin e brendshëm dhe metodologjinë e konsensusit, për të marrë vendime në një klimë të përshtatshme bashkëpunimi, larg polarizimit dhe konfliktualitetit politik.

- Të marrë masa të shpejta për hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të Kodit Zgjedhor, për përgatitjen e zgjedhjeve të përgjithshme të radhës në vitin 2013.

- “Të përkthejë” në plane dhe detyra konkrete pune gjetjet e Raportit Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet vendore 2011, të cilat kanë natyrë teknike dhe administrative, dhe t’i bëjë publike ato.

- Të përpunojë masa ligjore dhe administrative që forcojnë drejtimin hierarkik të administratës zgjedhore, në përputhje dhe në zbatim rigoroz të ligjit dhe njëkohësisht duke e mbrojtur atë nga ndërhyrjet apo influencat joligjore të partive politike.

- Të forcojë fushatat ndërgjegjësuëse dhe promovuese për nxitjen e pjesëmarrjes së lartë në ditën e zgjedhjeve, kontrollin dhe veprimet e mëtejshme ligjore të listës së zgjedhësve, procedurat e votimit dhe, në mënyrë të veçantë, eliminimin e votimit familjar.



- Të forcojë auditimin, në përputhje me ligjin, të financimit të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore.

- Të përpunojë dhe të miratojë rregulla standarde që garantojnë zbatimin korrekt të Kodit Zgjedhor për fushatën në media gjatë periudhës zgjedhore dhe të adresojë ligjërisht praktikatat e devijimit nga zbatimi i Kodit Zgjedhor apo ndikimit joligjor të subjekteve politike mbi zgjedhësit.

19 korrik 2012

KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)

**REZOLUTË  
PËR RAPORTIN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM “MBI GJENDJEN E  
KRIMINALITETIT PËR VITIN 2011”**

**Duke konsideruar se:**

- Prokuroria e Republikës së Shqipërisë është institucioni kushtetues, i ngarkuar me ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit;

- Lufta kundër kriminalitetit është e suksesshme vetëm duke ushtruar një ndjekje penale efektive dhe profesionale, e realizuar nga një institucion solid, i pavarur, i përgjegjshëm dhe profesional në zbatimin e Kushtetutës dhe të ligjeve;

- Lufta kundër kriminalitetit, me fokus të veçantë krimin e organizuar dhe korrupsionin, si dhe forcimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së institucionit të Prokurorisë, përbëjnë përparësi kyçe për Republikën e Shqipërisë në procesin e integrimit evropian;

**Kuvendi i Shqipërisë konstaton për vitin 2011:**

- Siç rezulton nga raporti, që i është paraqitur Kuvendit, gjendja e kriminalitetit paraqitet me një reduktim të intensitetit dhe të disa formave të krimit, si dhe të rritjes së koeficientit të kriminalitetit, sidomos për disa vepra penale të caktuara.

- Janë intensifikuar përpjekjet në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore, gjë e cila ka sjellë në vijimësi uljen e ndjeshme të këtij fenomeni.

- Ekziston vullneti për të intensifikuar luftën ndaj trafikut të lëndëve narkotike, por ka nevojë për të ashpërsuar politikën penale në trajtimin dhe ndjekjen e këtyre rasteve, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së Prokurorisë.

- Konfiskimi civil i aseteve që rrjedhin nga veprimtaria e krimit të organizuar dhe trafikimit, në zbatim të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, është rritur dhe forcuar gjatë vitit 2011.

- Bashkëpunimi mes Prokurorisë dhe institucioneve të tjera gjatë vitit 2011 ka sjellë impakt pozitiv në luftën kundër kriminalitetit dhe shembull domethënës janë funksionimi i grupeve task-forcë. Ka përpjekje për të intensifikuar bashkëpunimin nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit të nënshkruara midis institucioneve.

- Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë vijojnë të jenë të mira dhe treguesit e procesit të ekstradimit të shtetasve janë pozitive.

**Kuvendi kërkon nga Prokuroria për vitin 2012:**

- Të intensifikohet veprimtaria hetimore, veçanërisht në drejtim të reduktimit të çështjeve të pezulluara dhe çështjeve të pushuara, të cilat janë filluar kryesisht nga vetë Prokuroria;

- Të intensifikojë luftën ndaj të gjitha formave të krimit, trafikëve dhe krimit të organizuar, veçanërisht në ndërtimin e një vizioni të qartë për forcimin dhe ashpërsimin e politikës penale ndaj këtyre veprave;

- Të rrisë bashkëpunimin me të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit në Shqipëri nëpërmjet bashkëpunimit dhe vizionit të përbashkët për zero tolerancë ndaj krimit;

- Të vijojë rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë homologe, në zbatim të legjislacionit në këtë fushë;



- Të intensifikojë luftën ndaj korrupsionit në administratën qendrore dhe në atë vendore ndaj zyrtarëve dhe ndaj ish-zyrtarëve, duke kryer hetime proaktive, të shpejta dhe efikase, si dhe duke mbajtur regjistrim të njëjtë të rasteve, që nga referimi i tyre deri në ekzekutimin e vendimeve. Në mënyrë të veçantë, lufta ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë të jetë një përparësi themelore e Prokurorisë, duke forcuar kapacitetet investigative dhe duke ndryshuar mentalitetin për frymë korporativiste në këtë sistem;
- Të analizojë me përgjegjshmëri maksimale gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë për politikën penale dhe marrjen e masave efektive për përmbushjen e tyre;
- Të marrë masat e duhura për zbatimin e legjislacionit procedural penal për ruajtjen e sekretit hetimor, për ndalimin e publikimit të akteve procedurale dhe ndëshkimin e autorëve të nxjerrjes së tyre, sipas legjislacionit penal në fuqi;
- Të zhvillohen procedura transparente dhe larg konfliktit të interesit për emërimin, transferimin dhe karrierën e prokurorëve në sistemin e Prokurorisë;
- Të tregojë përgjegjshmëri të lartë dhe të ushtrijë vetëkritikë për nivelin e ulët të rezultateve nga bashkëpunimi me KLSH-në, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive apo agjenci të tjera në fushën e luftës ndaj kriminalitetit. Suksesi i këtij bashkëpunimi është kriter i mirëfilltë për veprimin e shtetit ligjor dhe të masave antikorrupsion, për të cilin organi i Prokurorisë është përgjegjësi kryesor dhe vendimtar;
- Të zbatojë me përpikëri dhe pa vonesë vendimet gjyqësore, të cilat prekin sistemin e Prokurorisë, si pjesë e procesit të rregullt ligjor.

19 korrik 2012

KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)

**DEKRET**  
**Nr. 7729, datë 6.8.2012**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimet e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Genita Ridvan Hoxha
2. Vesa Nahil Luma

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**



**DEKRET**  
**Nr. 7730, datë 6.8.2012**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe neneve 9, 10 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Rami Mehmed-Sejid Ismaili
2. Agim Rrahman Krasniqi
3. Ruzhdi Abdiraman Hoxha
4. Nihal Yüksel İçöz Gjana (Içöz)
5. Roger Antoine Romman
6. Tatjana Vladimir Slavinskaya (Kudrajavceva)
7. Sean Edward James Evert Mason
8. Mirije Sejdi Broli (Koçinaj)
9. Veysel Memet Ekinci
10. Blerta Ruzhdi Elezaj (Islamaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**

**DEKRET**  
**Nr. 7731, datë 6.8.2012**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Justina Xhelal Tanka (Haxhillari)
2. Margarita Sotir Roça
3. Renato Pano Skura
4. Petrit Ajet Hasapapaj
5. Ilirjet Zenel Mustafaj

6. Marika Jorgji Xega
7. Marika Ziko Roça
8. Thodhori Tasi Gjonçari
9. Elidon Thodhori Gjonçari
10. Kostanca Niko Mani
11. Enrid Petraç Grosler

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**

**DEKRET**  
**Nr. 7732, datë 7.8.2012**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U lejonet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- |                                       |   |
|---------------------------------------|---|
| 1. Lindita Muharrem Kurti             | 14. Olimbi Ndue Mici (Kolprekaj)          |
| 2. Enxhi Zenun Begzati                | 15. Enea Fatmir Mici                      |
| 3. Fabiola Alfred Shtëpani (Shtëpani) | 16. Ingrid Fatmir Mici                    |
| 4. Erol Thanas Milo                   | 17. Ornela Fatmir Mici                    |
| 5. Klodiana Xhevat Asllanaj (Osmanaj) | 18. Ralf Fatmir Mici                      |
| 6. Alban Ylli Seitaj                  | 19. Dorina Maliq Thelen (Sula)            |
| 7. Artur Shefik Grori                 | 20. Blerjana Kleanthi Terreping (Bezhani) |
| 8. Pegi Artur Grori                   | 21. Roland Zenel Sula                     |
| 9. Andris Arben Alija                 | 22. Adelina Misto Sula (Luli)             |
| 10. Jessika Avdyl Sadiku              | 23. Viola Roland Sula                     |
| 11. Gladiola Hatem Sadiku (Gjoni)     | 24. Kevin Roland Sula                     |
| 12. Rozeta Fiqiri Alaoui (Osmanaj)    | 25. Franz Roland Sula                     |
| 13. Meklaud Idriz Lushaj              |   |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**



**VENDIM**  
**Nr. 2, datë 27.3.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

|                   |           |
|-------------------|-----------|
| Shpresa Beçaj     | Kryesuese |
| Ardian Dvorani    | Anëtar    |
| Besnik Imeraj     | Anëtar    |
| Fatos Lulo        | Anëtar    |
| Ardian Nuni       | Anëtar    |
| Evelina Qirjako   | Anëtare   |
| Majlinda Andrea   | Anëtare   |
| Guxim Zenelaj     | Anëtar    |
| Aleksandër Muskaj | Anëtar    |
| Arjana Fullani    | Anëtare   |
| Mirela Fana       | Anëtare   |
| Andi Çeliku       | Anëtar    |
| Medi Bici         | Anëtar    |
| Edmond Islamaj    | Anëtar    |
| Shkëlzen Selimi   | Anëtar    |

në datën 27.3.2012 mori në shqyrtim në seancën gjyqësore çështjen civile me nr. 5 Akti, që ju përket palëve:

PADITËS: Filip Rroco, Kleopatra Qano, Nirvana Pistuli, Matilda Dovana, Natasha Dovana

NDËRHYRËS KRYESORË: Pandeli Strati, Grigor Nosi, Vasil Nosi, Rudolf Nosi.

I PADITUR: Aleksandër Miraj, i biri i Fabjanit, i datëlindjes 1957, banues në Tiranë.

**OBJEKTI**

1. Detyrimi i të paditurit Aleksandër Miraj me cilësinë e palës investitore, të realizojë në mënyrë të plotë në natyrë, në favor të paditësve dhe ndërhyrësve kryesorë, detyrimet që rrjedhin nga kontrata e investimit lidhur midis palëve në datë 13.10.2002, si dhe kontratat e shkëmbimit datë 24.5.2004 dhe 25.5.2004 të llogaritura me koeficientin 20% të sipërfaqes ndërtimore të objektit 8-katësh. Në pamundësi të realizimit 100% në natyrë të këtij detyrimi, sipas kuotave, detyrimin e tij ta kompensojë në vlerë me çmimin e tregut aktual për secilin bashkëpronar.

2. Detyrimin e ZVRPP-së Durrës të realizojë korigjimet, regjistrime, në bazë të raporteve që krijohen nga ky gjykim.

3. Pushimin e gjykimit për pjesën e objektit të padisë që i përket Fiqiri Ushina.

BAZA LIGJORE: neni 32 i Kodit të Procedurës Civile, neni 734 e vijues i Kodit Civil.

Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 1623, datë 10.7.2006, ka vendosur:

“Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë të paditësve, të ndërhyrësve kryesorë Filip Rroco, Kleopatra Qano, Nirvana Pistuli, Natasha Dovana, Matilda Dovana, Pandeli Strati, Vasil, Rudolf dhe Grigor Nosi, duke detyruar të paditurin Aleksandër Miraj për të realizuar detyrimet e paplotësuar që rrjedhin nga kontrata e investimit, lidhur midis palëve datë 13.10.2003, si dhe kontrata e shkëmbimit datë 24.5.2004 dhe 25.5.2004, duke llogaritur 20% koeficientin e sipërfaqes së ndërtimit të objektit 8-katësh në lagjen 13 Plazh, Durrës me detyrimin alternativ: Sipërfaqe ndërtimi ose vlera e tregut të këtyre sipërfaqeve, si detyrim i paplotësuar për secilin paditës e ndërhyrës kryesor, si pronar trualli, si vijon:

Paditësve Filip e Kleopatra Qano (trashëgimtarë të Behare Rroco), sipërfaqe në natyrë ose vlerën për:

$X = 25 \text{ m}^2 \text{ lokal} \times 1500 \text{ euro} = 37.500 \text{ euro}$

$X = 18 \text{ m}^2 \text{ papafingo} \times 450 \text{ euro} = 8.100 \text{ euro}$

$X = 10.8 \text{ m}^2 \text{ tarracë papafingo} \times 200 \text{ euro} = 2.160 \text{ euro}$

$X = \text{kthim shume për moszbatim të kontratës së shitjes nr. 1412, datë 18.6.2004 – (lokal)} = 2800$

euro.  
5936

Shuma e detyrimit në vlerë 50.560 euro.

Paditësve Matilda Dovana, Nirvana Pistuli, Natasha dhe Matilda Dovana (trashëgimtare e Vlash e Alfons Dovana), sipërfaqe në natyrë ose në vlerë për:

$X = 25 \text{ m}^2 \text{ lokal} \times 1500 \text{ euro} = 37.500 \text{ euro}$

$X = 18 \text{ m}^2 \text{ papafingo} \times 450 \text{ euro} = 8.100 \text{ euro}$

$X = 10.8 \text{ m}^2 \text{ tarracë papafingo} \times 200 \text{ euro} = 2.160 \text{ euro}$

Shuma e detyrimit në vlerë 47.760 euro.

Ndërhyrës kryesor: Pandeli Strati (trashëgimtar kryesor i Ksanthipi Strati), sipërfaqe në natyrë ose në vlerë për:

$X = 25 \text{ m}^2 \text{ lokal}/2 \times 1500 \text{ euro} = 18.750 \text{ euro}$

$X = 18 \text{ m}^2 \text{ papafingo}/2 \times 450 \text{ euro} = 4.050 \text{ euro}$

$X = 10.8 \text{ m}^2/2 \text{ tarracë papafingo} \times 200 \text{ euro} = 1.080 \text{ euro}$

Shuma e detyrimit në vlerë 23.830 euro.

Ndërhyrës kryesorë: Grigor e Rudolf Nosi (trashëgimtarë të Elsa Nosi-Dovana), sipërfaqe në natyrë ose në vlerë për:

$X = 25 \text{ m}^2 \text{ lokal} \times 1500 \text{ euro} = 37.500 \text{ euro}$

$X = 18 \text{ m}^2 \text{ papafingo} \times 450 \text{ euro} = 8.100 \text{ euro}$

$X = 10.8 \text{ m}^2 \text{ tarracë papafingo} \times 200 \text{ euro} = 2.160 \text{ euro}$

Shuma e detyrimit në vlerë 47.760 euro.

Nga shuma e mësipërme i zbritet 8000 euro, likuiduar nga i padituri Aleksandër Miraj, Rudolf Nosit, duke ngelur përfundimisht detyrimi në vlerë 47.860 euro - 8000 euro = 39.860 euro.

Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të objektit të padisë që lidhet me vlerën e detyrimeve si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Pushimin e gjykimit të çështjes për kërkimet që pala paditëse ka paraqitur ndaj Fiqiri Ushinës, për shkak të heqjes dorë nga gjykimi, bazuar në kriteret e nenit 201 të Kodit të Procedurës Civile”.

**Gjykata e Apelit Durrës**, me vendimin nr. 349, datë 6.9.2007, ka vendosur:

“Mospranimin e ankimit të bërë nga i padituri ndaj vendimit civil nr. 1623, datë 10.7.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak të paraqitjes së ankimit jashtë afatit 15 ditor.”

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr. 349, datë 6.9.2007, në mbështetje të nenit 432 të K.Pr.Civile, brenda afatit ligjor, ka ushtruar rekurs pala e paditur Aleksandër Miraj, duke kërkuar prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, për këto shkaqe:

- Gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar seancat gjyqësore pa njoftuar të paditurin dhe përfaqësuesin e tij.

- Në datën 2.8.2006 është vënë në dijeni avokati i të paditurit për vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ankimi është paraqitur brenda afatit në datën 17.8.2007.

- Në bazë të nenit 148 të K.Pr.Civile dhe vendimit unifikues nr. 14, datë 16.2.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, afati për paraqitjen e njoftimit llogaritet nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit.

**Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë**, me vendimin nr. (s’ka), datë 13.9.2011, ka vendosur:

“Kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore.”

#### KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relativimin e gjyqtarëve Fatos Lulo dhe Ardian Dvorani; përfaqësuesen e palës së paditur, Av. Mine Progonati, që kërkoi prishjen e vendimit nr. 349, datë 6.9.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës, me tjetër trup gjykues; përfaqësuesin e palës paditëse dhe i ndërhyrësve kryesor, av. Ulusi Bici, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 1623, datë 10.7.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe të vendimit nr. 349, datë 6.9.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës; si dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,



## VËREJNË:

Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se pala paditëse dhe ndërhyrësit kryesorë janë pronarë në dy sipërfaqe trualli prej 500 m<sup>2</sup> në plazhin e Durrësit. Me kontratën datë 13.10.2002, këto subjekte kanë rënë dakord që këtë sipërfaqe ta vinin në dispozicion të palës së paditur, me qëllim që kjo e fundit të ndërtonte një objekt banimi, jo më pak se 5 kate. Në ndërtimin që do të kryhej pala paditëse do të përfitonte 20% të sipërfaqeve të banimit dhe ambienteve të tjera. Përfundimisht, rezulton se mbi këtë sipërfaqe trualli janë ndërtuar dy godina 8-katëshe dhe mes palëve janë lidhur kontratat e shkëmbimit datë 24.5.2004, 25.5.2004, regjistrimin e të cilave pranë ZVRPP-së Durrës e kishte marrë përsipër pala e paditur. Kur paditësit kanë shkuar për t'u interesuar pranë ZVRPP-së për vërtetimet e pronësisë, rezulton se pjesët takuese në ZVRPP Durrës nuk ishin regjistruar sipas përmbajtjes së kontratës së shkëmbimit të nënshkruar mes palëve, po sipas një kontrate të përgjithshme shkëmbimi, ku figuronin disa prej bashkëpronarëve të tjerë, por nuk figuronin paditësit dhe ndërhyrësit kryesorë në pjesët që kishin rënë dakord.

Paditësit dhe ndërhyrësit kryesorë i janë drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me padinë objekt shqyrtimi. Gjatë hetimit, gjykata ka urdhëruar kryerjen e një akti ekspertimi, nga ku janë përcaktuar diferencat në sipërfaqe, të vlerësuara dhe në vlerë monetare, për palën paditëse dhe ndërhyrësit kryesorë.

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës vendosi të pranojë padinë duke njohur detyrimin e palës së paditur sipas dispozitivit përkatës. Në seancën e dhënies së vendimit, pala e paditur rezulton të ketë qenë në mungesë, kështu që konform nenit 316 të KPC-së, vendimi i gjykatës së shkallës së parë iu njoftua me dëftesë komunikimi më datë 2.8.2006. Rezulton se pas njoftimit të vendimit, pala e paditur paraqiti ankim kundër tij, ankim ky që u depozitua në sekretarinë gjyqësore më datë 17.8.2006.

Gjykata e Apelit Durrës, e cila u investua në gjykimin e çështjes pas paraqitjes së ankimit të mësipërm, nuk u mor me shqyrtimin e pretendimeve që kishin të bënin me themelin e çështjes. Ajo konstatoi se në referencë të nenit 444/1 të K.Pr.Civile, ankimi ishte i paraqitur jashtë afatit. Në vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës u argumentua se në zbatim të nenit 444, paragrafi i parë, për rastin konkret kur palës në mungesë, vendimi i është komunikuar me dëftesë komunikimi, afati 15-ditor fillon nga data e komunikimit të vendimit dhe jo nga e nesërmeja e shpalljes së vendimit. Sipas gjykatës, duke llogaritur datën e komunikimit të vendimit që është më datë 2.8.2006 dhe datën e dorëzimit të ankimit në kryesekretarinë e gjykatës, që është më datë 17.8.2006 ankimi është paraqitur jashtë afatit 15 ditor. Në këto kushte, duke iu referuar dispozitës së nenit 450 të K.Pr.Civile, Gjykata e Apelit Durrës vendosi mospranimin e ankimit.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs pala e paditur. Konstatohet se në rekurs, pala e paditur, duke iu referuar nenit 148 të K.Pr.Civile dhe vendimit unifikues nr. 14, datë 16.2.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka pretenduar se afati për paraqitjen e ankimit llogaritet nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit.

Çështja në fjalë u shqyrtua në dhomë këshillimi nga Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë, i cili vendosi kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore. Me vendimin datë 13.9.2011, **Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë** vendosi kalimin çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore me këtë arsytim dhe duke shtruar për diskutim si vijon:

*“Pala e paditur paraqiti rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, duke pretenduar se ankimi ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ishte paraqitur brenda afatit ligjor. Në rekurs, pala e paditur i referohet qëndrimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr.14, datë 16.02.2001, ku argumentohet se dhe në rastet e njoftimit të vendimit palës që ka qenë në mungesë gjatë shpalljes së tij (vendimit), afati për llogaritjen e ankimit fillon nga e nesërmeja e njoftimit me dëftesë komunikimi.*

*Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi shqyrtoi këtë pretendim në seancë gjyqësore, konstatoi se në momentin e miratimit të K.Pr.Civile, neni 444 “Fillimi i afateve të ankimit” kishte këtë përmbajtje:*

*“Afatet e caktuara në nenin e mësipërm janë të prerë dhe fillojnë nga dita e shpalljes së vendimit përfundimtar. Kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë në mungesë të njërit palë, ky afat*

*fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Afati për të shtruar kërkesën për rishikim dhe afati i kundërshtimit i një të treti fillojnë nga dita kur janë zbuluar rrethanat për të cilën bëjnë fjalë dispozitat përkatëse”.*

*Mbi këtë përmbajtje të nenit 444 të K.Pr.Civile, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 14, datë 16.02.2001, janë shprehur si vijon: “Në rastet kur gjykimi në apel bëhet në mungesë të palës, por janë respektuar kërkesat e neneve 460 e 461 të K.Pr.Civile për mënyrën e njoftimit të palëve, verifikimin e shkaqeve të mungesës dhe rregullsinë e njoftimit, vendimi përfundimtar i gjykatës së Apelit duhet t’i njoftohet palës në mungesë dhe afati 30 ditor i rekursit llogaritet nga e nesërmja e ditës së njoftimit”.*

*Këtë qëndrim Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e mbajtën për sa kohë në dispozitën e nenit 444 të K.Pr.Civile nuk ishte parashikuar se kur fillonte afati i paraqitjes së rekursit kur çështja në gjykatën e apelit ishte gjykuar në mungesë të palës që paraqiste rekurs dhe vendimi i gjykatës së apelit i ishte njoftuar prej sekretarisë.*

*Pas marrjes së vendimit unifikues nr. 14, datë 16.02.2001, nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ligjvënësi e ndryshoi përmbajtjen e dispozitës së nenit 444 të K.Pr.Civile “Fillimi i afateve të ankimit” (ligji nr.8812/2001, neni 73), duke i dhënë përmbajtjen që ajo ka dhe sot: “Afatet e caktuara në nenin e mësipërm janë të prerë dhe fillojnë nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar. Kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata e apelit, në mungesë të njëjës palë, ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Afati për të ushtruar kërkesën për rishikim fillon nga dita kur janë zbuluar rrethanat për të cilën bëjnë fjalë dispozitat përkatëse”.*

*Pra siç shihet, ligjvënësi në dispozitë, parashikoi se afati i paraqitjes së ankimit, edhe në rastet kur çështja është gjykuar në mungesë në gjykatën e apelit, do të llogaritet nga dita kur palës ankimuese i është njoftuar vendimi i gjykatës së apelit.*

*Në këto rrethana, kur vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është pararendës i ndryshimeve që i janë bërë dispozitës së nenit 444 të K.Pr.Civile me ligjin nr. 8812/2001, neni 73, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë erdhi në përfundimin se çështja duhet të dërgohet për gjykim para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me diskutimin e çështjes që vijon:*

***Kur çështja është gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë ose nga Gjykata e Apelit, në mungesë të njëjës palë, kur fillon afati i ankimit, nga dita e marrjes njoftim të vendimit, apo nga e nesërmja e marrjes njoftim të vendimit?***

*Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi e shqyrtuan çështjen në seancë gjyqësore, erdhën në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës duhet të priset, pasi është marrë në interpretim të gabuar të dispozitave procedurale civile dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, i cili duhet të marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara në ankimin (apel) të palës së paditur, shkaqe që kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes, për gjykimin e të cilës është investuar juridiksioni gjyqësor.*

*Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjatë gjykimit morën në konsideratë së pari dispozitat e K.Pr.Civile, përkatësisht nenet 144 dhe 444 të K.Pr.Civile, sikundër dhe qëndrimin e tyre në vendimin nr.14, datë 16.02.2001.*

*Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, ka parashikuar rregulla të përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me llogaritjen e afateve, me të cilat lidhet ushtrimi i të drejtave që ky Kod u njeh palëve ndërgjyqëse gjatë kryerjes së një gjykimi civil.*

*Konstatohet se dispozita e nenit 148 të K.Pr.Civile, i cili parashikon rregullin e përgjithshëm në llogaritjen e afateve ka mbetur e njëjta që nga momenti i miratimit dhe hyrjes në fuqi të Kodit, pa pësuar ndryshime të mëtejshme. Kështu në këtë dispozitë, ligjvënësi ka parashikuar si vijon:*

***“Llogaritja e afateve  
Neni 148***

*Kur afati është caktuar me ditë dhe me orë, përjashtohet dita dhe ora në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati.*

*Afati që është caktuar në javë, në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite të javës së fundit, ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ka filluar afati.*

*Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.*



*Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit”.*

Ndërkohë, që në pjesën e III të Kodit të Procedurës Civile, titulli I, kreu I, në nenin 444, në momentin e miratimit dhe hyrjes në fuqi të Kodit, ligjvënësi kishte parashikuar si vijon:

**“Fillimi i afateve të ankimit  
Neni 444**

*Afatet e caktuara në nenin e mësipërm janë të prerë dhe fillojnë nga dita e shpalljes së vendimit përfundimtar. Kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë në mungesë të njëjës palë, ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Afati për të ushtruar kërkesën për rishikim dhe afati i kundërshtimit i një të treti fillojnë nga dita kur janë zbuluar rrethanat për të cilën bëjnë fjalë dispozitat përkatëse”.*

Vlen për t’u theksuar se mbi këtë përmbajtje të dispozitës së nenit 444 të K.Pr.Civile, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë u shprehën me vendimin nr. 14, datë 16.2.2001, duke ardhur në përfundimin se në rastet kur gjykimi në apel bëhej në mungesë të njëjës ose të dyja palëve ndërgjyqëse, afati 30 ditor i paraqitjes së rekursit për këto subjekte niste të llogaritej nga e nesërme e njoftimit të vendimit të gjykatës së apelit, njoftim që kryhej sipas rregullave të posaçme të parashikuara në K.Pr.Civile.

Sikundër u tha më lart, dispozita e nenit 444 të K.Pr.Civile pësoi ndryshime në vijim. Kështu përmbajtja e saj ndryshoi bazuar në nenin 73 të ligjit nr. 8812, datë 17.5.2001, duke marrë përmbajtjen që ajo ka dhe sot si vijon:

**“Neni 444  
Fillimi i afateve të ankimit**

*Afatet e caktuara në nenin e mësipërm janë të prerë dhe fillojnë nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar. Kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata e apelit, në mungesë të njëjës palë, ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit.*

*Afati për të ushtruar kërkesën për rishikim fillon nga dita kur janë zbuluar rrethanat, për të cilën bëjnë fjalë dispozitat përkatëse”.*

Sikundër konstatohet, duke qenë se dispozita pa ndryshimet e vitit 2001 nuk kishte parashikuar mënyrën e llogaritjes së afatit për paraqitjen e ankimit (rekurs) ndaj vendimit të gjykatës së apelit, prej subjekteve në mungesë gjatë gjykimit, boshllëk ky që u plotësua nga qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 14, datë 16.2.2001, ligjvënësi zgjodhi të barazojë këtë rrethanë ligjore me atë të parashikuar që më parë në këtë dispozitë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se llogaritja e afateve kohore është një element i nevojshëm në aplikimin e një numri dispozitash ligjore, të vendimeve gjyqësore dhe administrative si dhe klauzolave kontraktore. Në këtë aspekt mund të përmenden rregullat për parashkrimin shues, rregullat në lidhje me kohën brenda së cilës duhet të bëhet një ankim ose nene të kontratës lidhur me afatin kohor për pagesën e një borxhi etj.

Afatet procedurale caktohen nga Kodi i Procedurës ose nga ligje të veçanta. Kohëzgjatja në të cilin një akt procedural duhet të realizohet (për shembull, afati i paraqitjes së ankimit kundër vendimit, nën rrezikun e mospranimit të ankimit), është shprehur sipas rastit në ditë, muaj apo vite.

Sikundër u përmend më lart, afati i ankimit të vendimit është parashikuar në nenin 444 të K.Pr.Civile, ndërsa neni 148 të K.Pr.Civile përmban rregullime të përgjithshme të cilat aplikohen lidhur me llogaritjen e afateve, sipas të cilit kur afati është caktuar me ditë dhe me orë, përjashtohet dita dhe ora në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati.

Siç shihet, neni 148 i K.Pr.Civile shpreh në mënyrë besnike parimin “*Dies a quo non computatur in termino*” sipas të cilit, në llogaritjen e afateve në ditë, dita e fillimit (*a.q. dies a quo*) nuk llogaritet në ecjen e afatit, ndërsa dita e fundit (*a.q. dies ad quem*) llogaritet në afat.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nisur nga karakteri i situatës juridike të shtruar për diskutim e gjetjen, me vend t’i referohen dhe akteve ndërkombëtare që rregullojnë mënyrën e llogaritjeve të afateve. Kështu, një ndër këto instrumente është dhe “Konventa Europiane për llogaritjen e afateve kohore”



(Basle, 16.5.1972, CETS No. 076), e cila ka për qëllim që të unifikojë në këtë fushë ligjet e shteteve anëtare të Këshillit të Europës. Edhe në këtë Konventë (*e cila nuk është ratifikuar ende nga vendi jonë*), përcaktohen afatet kohore lidhur me aspekte apo kushte të ndryshme ligjore për të cilat është e nevojshme kryerja apo moskryerja e veprimeve të caktuara, të cilat, për sa i përket vlefshmërisë apo efekteve ligjore të tyre, kërkohet që të bëhen brenda afateve kohore të caktuara.

Në nenin 2 kjo Konventë parashikon se termi *dies a quo* nënkupton ditën nga e cila ecën afati ndërsa termi *dies ad quem* nënkupton ditën në cilën afati skadon.

Sipas nenit 3 të Konventës, afatet kohore të shprehura në ditë, javë, muaj apo vite do të fillojnë nga *dies a quo* në mesnatë dhe *dies ad quem* në mesnatë. Siç përshkruhet dhe në relacionin shoqërues të Konventës, ky paragraf ndjek rregullin, i cili është pranuar në shumicën e shteteve anëtare, se dita në të cilën afati fillon (*dies a quo*) nuk duhet të merret në konsideratë në llogaritje, ndërsa dita në cilën ai mbaron (*dies ad quem*) duhet të merret në konsideratë. Termi mesnatë nënkupton orën 24. Pra edhe Konventa parashikon se afati i shprehur në ditë apo në një ndarje tjetër kohore fillon nga dita e nesërme dhe konkretisht mbas orës 24 të *dies a quo*.

Të njëjtin qëndrim mban edhe rregullorja (EEC Euratom) nr. 1182/71 e Këshillit e datës 3.6.1971, që përcakton normat e aplikueshme për periudhat kohore, datat dhe afatet, të cilat zbatohen për aktet e Këshillit ose Komisionit, të miratuar apo për t'u miratuar në bazë të Traktatit që krijon Komunitetin Ekonomik Europian apo të Traktatit që krijon Komunitetin Europian të Energjisë Atomike.

Sipas nenit 3, paragrafi 1 të rregullores në fjalë, nëse një periudhë kohore e shprehur në javë, muaj apo vite, duhet të llogaritet duke u nisur nga momenti në të cilin verifikohet një ngjarje apo kryhet një veprim, dita në të cilën verifikohet kjo ngjarje apo kryhet ky akt nuk llogaritet në periudhën në fjalë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se është rregull gjerësisht i pranuar se *dies a quo* nuk llogaritet në afatin kohor brenda të cilit verifikohet një ngjarje apo duhet të kryhet një veprim i caktuar, rregull ky i cili ka gjetur shprehjen e tij edhe në Kodin e Procedurës Civile të Shqipërisë në nenet 148, 433, 444/1 të K.Pr.Civile.

Në këto rrethana, neni 444/2 i Kodit të Procedurës Civile parashikon një qasje tjetër lidhur me fillimin e afatit të ankimit për palën e cila ka qenë në mungesë, duke përcaktuar se ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Në këtë mënyrë ky paragraf bën një *derogim* nga rregulli i përgjithshëm, ndonëse ky rast (*mungesa e palës dhe fillimi i afatit në ditën e njoftimit të vendimit*) nuk është në vetvete një rast përjashtimor, i atillë që të justifikojë, në formën e një përjashtimi nga rregulli, moszbatimin e rregullave të përgjithshme lidhur me llogaritjen e afateve. Për më tepër, kjo situatë e vendos palën në mungesë në një pozitë procedurale më pak të favorshme (dhe për rrjedhojë jo të barabartë) sesa pala e cila ka qenë prezent në seancë, për të cilën Kodi parashikon se afati fillon nga e nesërmja e ditës së shpalljes së vendimit.

Në këto kushte nxirret konkluzioni se gjendemi para dy dispozitave kontradiktore, ku njëra shpreh rregullin e përgjithshëm për llogaritjen e afateve, i konfirmuar edhe në dispozita të tjera të veçanta të Kodit, dhe tjetra, e cila përmban një rregull të veçantë, i cili në vetvete nuk është shumë i dallueshëm nga rregulli i përgjithshëm, dhe nuk dallohet shkaku justifikues se pse ky rast (*mungesa e palës*) duhet të ketë një parashikim të ndryshëm nga rastet e tjera që parashikon rregulli i përgjithshëm, në një kohë që si rregulli i përgjithshëm dhe ai i veçantë i konsideruar, përfshihen në të njëjtën kategori konceptuale, dhe konkretisht "fillimi i afateve të ankimit". Dallimi i bërë nga ligjvënësi nuk është i atillë që të justifikojë nga çfarëdo pikëpamje (*logjike apo juridike të tilla si shpejtësia e gjyqimit, ekonomia gjyqësore etj.*) fillimin e afateve në mënyrë të ndryshme për palën që ka qenë prezent dhe për palën që ka qenë në mungesë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se në rastin konkret vlen për t'u theksuar parimi "të gjithë janë të barabartë përpara ligjit", parim kushtetues ky që gjen shprehje në nenin 18/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Nga ky parim i sanksionuar në aktin normativ me fuqi mbizotëruese në Republikën e Shqipërisë (*neni 116/1/a i Kushtetutës*) gjen burim dhe parimi i "barazisë së armëve", i cili pasqyrohet në pjesën e përgjithshme të dispozitave të K.Pr.Civile, dispozita këto që u njohin të njëjtat të drejta/detyrime palëve ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor civil në gjykatat e sistemit gjyqësor shqiptar.

Çdo interpretim i kundërt në këtë rast i dispozitës së nenit 148, në referencë të përmbajtjes së dispozitave të nenit 444 të K.Pr.Civile, do të vinte palët e gjykuara në mungesë, në një pozitë më pak të favorshme në ushtrimin e të drejtave, që ligji ua njeh të gjithave palëve pjesëmarrëse në gjykimin civil nga juridiksioni gjyqësor shqiptar.



Nisur edhe nga këto konsiderata në lidhje me normën kushtetuese të mësipërme, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vijnë në përfundimin se **kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata e apelit, në mungesë të njëjës palë, afati i ankimimit (apel, rekurs) për këtë palë fillon të llogaritet përkatësisht nga e nesërmja e marrjes njoftim të vendimit, sipas rregullave të përcaktuara nga dispozitat e neneve 316 dhe 148 të K.Pr.Civile.**

Në këto kushte, Gjykata e Apelit Durrës, gjatë rigjykimit të çështjes, do të duhet ta konsiderojë të paraqitur në afat ankimit (apel) të palës së paditur dhe të marrë në shqyrtim shkaqet e pretenduara në këtë akt, në lidhje me zgjidhjen e themelit të çështjes.

#### PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 485/c të Kodit të Procedurës Civile,

#### VENDOSËN:

Prishjen e vendimit nr. 349, datë 6.9.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Shpresa Beçaj (kryesuese), Ardian Dvorani, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Ardian Nuni, Evelina Qirjako, Majlinda Andrea, Guxim Zenelaj, Arjana Fullani, Aleksandër Muskaj, Mirela Fana, Andi Çeliku, Edmond Islamaj, Shkëlzen Selimi.

Anëtarë kundër: Medi Bici

#### MENDIM PAKICE

Unë, gjyqtari në pakicë **Medi Bici**, në bazë të nenit 307/2 të Kodit të Procedurës Civile, parashtroj me shkrim mendimin tim kundër, për t’ia bashkëngjitur vendimit nr.2, datë 27.3.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes ka rezultuar e provuar si më poshtë:

Paditësat Filip Rroco etj., i janë drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke kërkuar që të detyrohet i padituri Aleksandër Miraj që të realizojë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e investimit, e datës 13.10.2002 etj.

Në përfundim të gjykimit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 1623, datë 10.7.2006 ka vendosur:

Pranimin e pjeshëm të kërkesëpadisë etj.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 349, datë 6.9.2007 ka vendosur:

Mospranimin e ankimit të paraqitur nga i padituri Aleksandër Miraj, pasi ai është jashtë afatit 15-ditor....

Kundër vendimit nr. 349, datë 6.9.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës ka paraqitur rekurs i padituri Aleksandër Miraj dhe Kolegji Civil me vendimin e datës 13.9.2011 ka vendosur:

Kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore, duke shtruar për zgjidhje pyetjen e mëposhtme:

***Kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata e apelit, në mungesë të njëjës palë kur fillon afati i ankimit, nga dita e marrjes njoftim të vendimit, apo nga e nesërmja e marrjes dijeni të vendimit?***

Në ndryshim nga qëndrimi i shumicës pakica vlerëson se vendimi nr. 2, datë 27.3.2012 i Kolegjeve të Bashkuara ka ndryshuar nenin 444 të K.Pr.C., duke i dhënë rreshtit të fundit të paragrafit të dytë të kësaj dispozite ligjore këtë përmbajtje:

.....ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.... në vend të përmbajtjes së mëparshme  
.....ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit.....

Vlerësimi i pakicës është se, unifikimi i praktikës gjyqësore bëhet vetëm nëpërmjet interpretimit të ligjit në kuptimin e gjerë dhe të ngushtë të tij, duke përdorur katër format e interpretimit (literale, historike, logjike dhe gjuhësore), por asnjëherë gjykata nuk duhet të deformojë vullnetin e ligjvënësit.

Është detyrë e gjykatës që, gjatë interpretimit të ligjit, të nxjerrë në pah atë që ka dashur të thotë në të vërtetë ligjvënësi dhe jo t'i marrë atij kompetencat, duke ndryshuar ligjin, sepse neni 444 i Kodi i Procedurës Civile përcakton mjaft qartë se për palën në mungesë afati fillon nga dita e njoftimit të vendimit dhe në këtë rast nuk ka vend për asnjë lloj keqinterpretimi.

Duhet theksuar se për këtë dispozitë ligjore ligjvënësi ka pasur një qëndrim të konsoliduar, sepse neni 444 i Kodi i Procedurës Civile ka ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, ndërsa më përpara Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ishin shprehur me vendimin nr. 14, datë 16.2.2001 në lidhje me momentin e fillimit të afatit të rekursit kundër vendimit të gjykatës së apelit dhe nëse do të ekzistonte vullneti i ligjvënësit, ai do të kishte pasqyruar në ligj qëndrimin që kishin mbajtur Kolegjet e Bashkuara në vendimin nr. 14, datë 16.2.2001, por me ndryshimet që iu bënë ligjit vendimi unifikues i mësipërm mbeti pa fuqi ligjore.

Në arsyetimin e vendimit Kolegjet e Bashkuara i referohen Konventës Europiane për llogaritjen e afateve dhe Rregullores Euroatom, duke u shprehur se kjo Konventë nuk është ratifikuar nga vendi ynë.

Pakica është e mendimit se qëndrimi i shumicës është në kundërshtim me nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pasi kanë fuqi ligjore në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

Edhe në thelb zgjidhja që ka bërë shumica është e gabuar, pasi ajo e justifikon qëndrimin e saj me shkeljen e barazisë së armëve, parim që rrjedh nga neni 18/1 i Kushtetutës, por pakica vlerëson se përcaktimi që bën neni 444 i K.Pr.C. është i drejtë, sepse palës që është në mungesë në momentin që i njoftohet vendimi i dorëzohet një kopje e tij, prandaj kjo palë që nga ky moment i ka të gjitha mundësitë që të fillojë përgatitjen për dorëzimin e ankimit.

Ndërsa në rastin kur pala është prezent ajo e dëgjon shpalljen e vendimit me anën e leximit të gjykatës, por i ka të pakta mundësitë që të marrë po atë ditë një kopje të zbardhur të vendimit, madje sipas nenit 308/2 të Kodit të Procedurës Civile në çështje të ndërlikuara gjykata ka të drejtë të shpallë vetëm dispozitivin dhe e dorëzon vendimin e arsyetuar në sekretari brenda 10 ditëve, që do të thotë se pala që është prezent e merr vendimin me 10 ditë vonesë, duke i mbetur në dispozicion një kohë vetëm prej 5 ditësh për përgatitjen dhe dorëzimin e ankimit.

Arsyetimi i mësipërm të çon në përfundimin se, ashtu siç është ndërtuar Kodi ynë i Procedurës Civile, pala që është në mungesë gjatë shpalljes së vendimit ka pozita më të favorshme se pala që është prezent në shpalljen e tij, për sa i përket kohës që ka në dispozicion për paraqitjen e ankimit.

Duke arsyetuar si më sipër vlerësoj se vendimi nr. 349, datë 6.9.2007 i Gjykatës së Apelit Durrës është i bazuar në ligj dhe për rrjedhojë ai duhet të lihet në fuqi, prandaj vota ime është kundër vendimit nr. 2, datë 27.3.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Anëtar: Medi Bici

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 20.8.2012  
Doli nga shtypi më 22.8.2012

|               |                  |
|---------------|------------------|
| Tirazhi: 1200 | Formati: 61x86/8 |
|---------------|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 30 lekë